



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Drejtoria Për Mbrojtje, Shpëtim
Dhe Shërbime Publike

09 Nr. _____ /2024

Dt. 31 / 05 /2024

Thirrje Publike

Titulli : MONITORIMI DHE IDENTIFIKIMI I OBJEKTIVAVE TË PROJEKTEVE TË ENERGJISË EFIÇENTE NË KOMUNËN E DEÇANIT

Hyrja

Bazuar në Strategjinë e Energjisë të Republikës së Kosovës 2022-2031, ligjin nr.06/1-079 për efikasitet të energjisë, për masat e ripërtitshme të energjisë, përkatësisht në sektorin e Arsimit dhe Shëndetësisë ,si dhe bazuar në studimet e mbështetura nga zyra e BE-së përmes sekretariatit të Komunitetit të energjisë si 2TU Wien, EEG,REKK(2019), Studim mbi objektivat e përgjithshme deri në vitin 2030 ,kursimit të energjisë në Kosovë deri në vitin 2030 (referuar si "Studim i BE-së " dhe "Skenari EnC29").Caku i përgjithshëm për Efikasitetin e Energjisë është të kufizojë konsumin përfundimtar të energjisë deri në nivelin 1877 ktoe në vitin 2031-të si dhe Planin të Qëndrueshëm për Energji dhe Klimë 2019-2030 për Komunën e Deçanit.

Komuna e Deçanit përmes këtij projekti synon që të monitorojë të gjitha projektet që janë zhvilluar në Komunën e Deçanit në fushën e Efikasitetit të Energjisë ,të financuara nga Komuna e Deçanit ,Fondi i Kosovës për efikasitet të energjisë, Niveli Qendror ,investimet nga ESCO kompanitë si dhe donatorë të tjerë. Monitorimi i projekteve ka për qëllim që të paraqesë përfitimet e projekteve për kursim të energjisë përballë donatorëve ,të cilët kanë qenë pjesë e investimeve të këtyre projekteve, ku Komuna e Deçanit është zotuar se do të bëjë një përmbledhje të projekteve për të raportuar te donatorët si dhe te Ministria e linjës që kanë detyrim ndaj Traktatit të Komunitetit të Energjisë që të raportojnë në baza vjetore për kursim të energjisë dhe hartimin e politikave për efikasitet të energjisë .

Aktivitet :

Identifikimi i objektivave: Fillimisht duhet të identifikohen objektivat e kursimit të energjisë të projekteve.

Analiza e konsumit të energjisë fillestare : Do të kërkohen të dhënat e konsumit të energjisë para se të implementohet projekti dhe të bëhen krahasimet pas përfundimit të projektit.

Planifikimi i veprimeve :Bazuar në analizën e konsumit aktual të energjisë ,duhet të shikohet se a është zbatuar projekti sipas planit të veprimit.

	DEÇAN - DEÇAN - DEÇAN REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E DEÇANIT - OPSTINA DEÇAN - DEÇAN MUNICIPALITY
Nr. i dokumentit 09	09
Nr. i fletës 16972	16972
Datë 31-05-24	31-05-24

Identifikimi i masave : Do të bëhet identifikimi i masave të efikasitetit të energjisë në sektorin e shërbimeve.

Monitorimi dhe vlerësimi: Është e rëndësishme të monitorohen përfitimet e veprimeve të ndërmarra për kursimin e energjisë. Kjo përfshin monitorimin e konsumit të energjisë pasi të jenë zbatuar veprimet e kursimit të energjisë ,si dhe vlerësimin e ndikimit të tyre në shpenzimet dhe performancën e përgjithshme të energjisë.

Përditësimi dhe rishikimi: Bazuar në rezultatet e monitorimit ,duhet të bëhen përditësime në veprimet e ndërmarra për të siguruar që objektivat e kursimit të energjisë janë të arritura në mënyrë efektive .Kjo mund të përfshijë rishikimin e politikave si Planin për Energji dhe Klimë etj.

Raportimi: Të raportohen rezultatet e kursimit të energjisë në nivelin e përgjithshëm të projekteve përballë Komunës së Deçanit.

Raporti përfundimtar duhet të hartohet në gjuhën Shqipe dhe Angleze .

Financuesi i aktiviteteve për hartimin këtij Dokumenti është Komuna e Deçanit.

Komuna e Deçanit u bën thirrje OJQ-ve dhe OE si dhe të gjitha palëve të interesuara (ofrues të shërbimeve), fushëveprimi i të cilëve është i fokusuar në fushën e energjisë/shërbimeve të energjisë etj.

Vlera totale e planifikuar e thirrjes është **45,500.00 EURO**.

Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është 15 ditë kalendarike nga data e publikimit (nga data **31.05.2024**) dhe përfundon me **14.06.2024** në ora **11:30**.)

Kohëzgjatja e projektit për hartimin e PKVEK-së për Komunën e Deçanit.

Periudha e zbatimit të kontratës është 3 muaj (shënim: Kontrata duhet të përfundojë në Gusht 2024)

Të drejtë aplikimi kanë ofrues të shërbimeve si OJQ-të dhe OE-të që plotësojnë kriteret e lartpërmendura dhe që dëshmojnë staf të përgatitur në këtë fushë.

Në staf duhet të ketë tre (3) inxhinier: Elektro, Ndërtimtari dhe Makineri.

Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen në formën fizike dhe në Ndërtesën e Komunës-Zyre të Shërbimeve Publike,nr.26.

Procesi i pranimit ,hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve/ofertave ,vlerësimit të aplikacioneve/ofertave , kontraktimi ,koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të thirrjes janë konform ligjit.

Për informata të nevojshme ju lutem të shkruani në email-in: shkelzen.goqi@rks-gov.net